

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot në datë 18.08.2017 në takimin: Dëgjesa publike per buxhetin afat mesem 2018-2020 si dhe projekt-buxhetin e vitit 2018.

Në këtë dëgjese marrin pjesë: N/Kryetari i Bashkisë Z.Çlirim Brisku, Kryetari i Lagjes Nr.1 Z. Mirel Konomi, këshilltarët si dhe qytetarë të lagjes Nr.1.

Mirel Konomi: Kryetar i Lagjes Nr.1 , i cili sqaron se për çfarë bëhet kjo dëgjese.

Çlirim Brisku: N/Kryetar i Bashkisë, në bazë të Ligjit është detyrim dëgjesa publike për buxhetin afat mesem 2018-2020 si dhe projekt buxhetin 2018. Ato kanë si qëllim që të njihemi me nevojat , shqetësimet , problemet që ka komuniteti i Bashkisë Berat.

Haki Sula- Banor i lagjes Nr.1, ngreh shqetësimin për ujërat e zeza në krahun e djathtë të Rrugës "Pal Golemi" si dhe problemin e ndriçimit. Propozon që tek lagja nën rrugë të ndërtohet një shkollë e 9 vjecare që të vijojnë shkollën fëmijët e zones deri ne Otlak.

Perparim Turhani -A ka projekt për kanalizimet e ujërave të zeza mbi shkollën "Zihni Toska", Rruga "Haxhi Ceno" dhe rruga e Bregut."

Qytetar- Banor i pallatit Nr.59, Lagja "Murat Çelepiu" ngreh shqetësimin e ujërave të zeza.

Edmond Ikonomi: - Banor i lagjes Nr.1 si dhe drejtor i shkollës "Zihni Toska", tek NSHG-ja, të disiplinohet kalimi i makinave. Ngreh shqetësimin e ngrohjeve në shkolla, tek shkolla "Zihni Toska" në të tre anët e saj duhet të disiplinohen ujërat.

-Tek pallati që ka ndërtuar firma "Konuda" mbas shkolles "28 Nwntori" të rregullohet rruga.

Vladimir Yzeiri - Ngreh shqetësimin për sistemimin e ambjentit të lulishtes përballë shkollës "Zihni Toska", me rrugica , ndriçim ,stola, kanalizim te ujrave të lulishtes.

Vlash Lapi -Tek pallati 59 kërkohet të vihet një prozhektor për ndriçim , pasi nuk kalojmë dot.

Llambi Stefa: Jam i pastrehë, kërkohet që të ndihmohem nga Bashkia me strehim.

Sokol Turhani -Banor i Lagjes "Çlirim" pyet : "Pse duhet që projekti i KFW-së të zgjasë kaq shumë për lagjen tonë kur gjithë qytetin e Korçës e bëri për 2 vjet. Duhet përkushtim më i madh nga Bashkia me forca fizike për sistemime në lagje.

Gëzim Kushova- Tek rruga "Haxhi Ceno" rruga është shumë e keqe , duhet rregulluar.

-Tek shtrimi i pllakave para shkollës "Zihni Toska" lë për të dëshiruar. Duhet të shikohet cilësia e shtrimit të tyre, atje ku janë hequr pemët.

- Rrugicat të cilat janë shtruar me kalldrëm nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike , jane shtruar pa cilësi.

MBAJTËSI I PROCES VERBALIT

Mevlude Vrusho



PROCES VERBAL

I mbajtur sot në datë 22.08.2017 në dëgjuesën publike për buxhetin afatmesem 2018-2020 si dhe projekt buxhetin 2018 me biznesin e qytetit Berat.

Në dëgjuesë marrin pjesë: N/Kryetari i Bashkisë Z.Çlirim Brisku,këshilltarë , Kryetari i lagjes Nr.2 si dhe banorë të lagjes Nr.2.

Çlirim Brisku: N/Kryetari i Bashkisë , flet për çka do të bëhet në këtë lagje për vitet e ardhshme.

Lulëzime Meçe: Banor i Lagjes Pjeshkore, kërkon të bëhet ndriçimi i rrugës pasi nuk ka ndriçim.

Novruz Praka: Banor i Lagjes “Kodra e Sulmit” ngreh problemin e rrugës , gjithashtu dhe të ujërave të zeza që kalojnë tek kanali i zbuluar tek MCR-ja.

Demokrat Keli : Banor i Lagjes “22 Tetori” (tek ish merkata ne qendër) rruga që lidhet me pedonalen është shumë e keqe,duhet vënë dorë.

Astrit Karapiti: Banor i Lagjes “ 28 Nëntori” afër Kodrës së Sulmit , duhet të ndërhyhet tek një murë i lartë i cili rrezikon te bjerë.

MBAJTËSI I PROCES VERBALIT

Mevlude Vrusho



PROCES VERBAL

I mbajtur sot në datë 25.08.2017 në dëgjesën publike për buxhetin e vitit 2018-2020 si dhe projekt buxhetin 2018 me komunitetin e lagjes Nr.3 të qytetit Berat.

Në dëgjesa marrin pjesë: N/Kryetari i Bashkisë Z.Çlirim Brisku, N/Kryetare e Bashkisë Znj.Teuta Muçogllava, Kryetari i Lagjes Nr.3 Z.Klaudio Kumani këshilltarët si dhe banorë të Lagjes Nr.3.

Çlirim Brisku: N/Kryetar i Bashkisë, hap dëgjesën duke falenderuar për pjesëmarrjen , sqaron lidhur përse zhvillohet kjo dëgjesë, duke paraqitur para komunitetit të Lagjes Nr.3, ç'farë është bërë dhe ç'farë do të bëhet në të ardhmen.

: Banor i lagjes “10 Korriku” tek MCR-ja. Kur do të parashikohet bërja e rrugës tek MCR-ja e cila të çon tek Kisha? Jam i ardhur nga fshati Mbjeshevë , banoj tek MCR-ja , larg nga qendra e qytetit 300 m , nuk ka kanale të ujërave të zeza, rruga është shumë e keqe, ndriçim nuk ka. Na është premtuar në fushatë dhe asgjë nuk është bërë.

Luljeta Gjeçi: Banore e Lagjes” 10 Korriku”, MCR- ngreh shqetësimin e ndriçimit të rrugës, rrugë nuk ka , kanalizime jo, gjithashtu nuk ka kosha plehrash. Të zgjerohet rruga pasi janë ngushtuar nga banoret e lagjes.

Xhozhi Gjoka: Këshilltar në Bashki, e njoh shumë mirë këtë zonë pasi kam qënë për shumë vite Kryetar i lagjes Nr.3, të gjitha ato shqetësime që u trajtuan nga banorët e lagjes “10 Korriku” tek MCR-ja janë të drejta , pasi aty nuk është ndërhyrë asnjëhere.

Dallandyshe Spahi: Banoj në lagjen “ 10 Korriku” MCR-ja jemi mbytur 3(tre) herë nga kanali që mbledh ujërat që vijnë nga L “Kodra e Sulmit”, pasi nuk pastrohet kanali.

Fortunato Boçi:Banor i Lagjes “Uznovë”, ngreh shqetësimin e rrugës që shkon në Mimias , nuk ka ndriçim , kanalizime nuk ka, aty janë 4(katër) biznese që i japin zhvillim zonës. Të bëhet një kënd lojrash për fëmijet tek Stacioni Metereologjik.

- Të bëhet vijëzimi i rrugëve, vijat e bardha.

-Kthesa tek rruga e Agim Kullaut ,të zgjerohet rruga sepse nuk shkëmbehen dot dy makina

Feim Ruka: Banor i lagjës “Uznovë”, vlerësoj projektet për parashikimet e Bashkisë për buxhetin e ardhshëm. Dihet që kërkesa ka më shume se mundësi për t'u bërë.

Ngreh shqetësimin se Uznova ka ngelur jashtë vëmëndjes:

1) Lagjia "Uznovë" ka nevojë për ujitje, pasi ka vite që nuk ka një pikë ujë për ujitje. Ka 2 rezervuar , të cilët nuk sjellin asnjë pikë ujë.

2) Të gjitha rrugët tek ish Blloku i Fiqve duhet të pastrohen dhe riparohen.

3. Rruga tek Uznovë e Madhe duhet të bëhet nga të dyja anët me trotuare dhe të ketë kolektor anësor të ujërave të zeza. Infrastruktura tek Uznovë e Madhe lë për të dëshiruar ashtu edhe në lagjet e Uznovës.

Petrit Nasufi: Lagja "1 Maji" Uznovë nuk ka ndriçim , duhet të shtrohet me çakull.

Abedin Kajo:


1) Prishja e ndërtimeve pa leje në katet e para të pallateve, të cilat kanë zënë hapësirat publike dhe mbajnë të rrethuar pallatet.

2) Ngreh shqetësimin e qenëve rrugaçë, pasi një qenë është shumë i sëmurë , ka 2(dy) ditë që fle para Bashkisë dhe është burim sëmundje.

3) Duhet të tërhiqet vëmëndje punonjësve të Policisë Bashkiake , të cilët nuk janë serioz në punën e tyre, në orarin e punës ulen nëpër lokale , prishin qetësinë .

MBAJTËSI I PROCES VERBALIT

Mevludë Vrusho



PROCES VERBAL

I mbajtur sot në datë 30.08.2017 në dëgjesën publike për buxhetin *afatmesëm 2018-2020 si dhe projekt buxhetin 2018 me Komisionin Qytetar.*

Në dëgjesë marrin pjesë: N/Kryetare e Bashkisë Teuta Muçogllava , këshilltarë, Komisioni Qytetar, qytetarë të ndryshëm, grupe interesi , OJF.

Teuta Muçogllava: Ky është takimi i fundit për buxhetin 2018 -2020 dhe Projekt buxhetin 2018, pas takimeve në katër Njësitë Administrative Sinjë, Roshnik, Velabisht, Otlak, dhe tre lagjet e qytetit të Beratit. Komisioni Qytetar është ngritur në Berat nga USAID-i me koordinator Z.Vladimir Çela dhe strukturë komunitare në 3 lagjet e qytetit.

Llambi Guxhumani: A parashikon bashkia një fond meremetimi për zonën muzeale për banesat , të cilat po shkatërrohen , janë të pabanuara. Të bëhet një studim dhe të akordohet një fond se po shkatërrohen lagjet muzeale.

Vladimir Çela: Koordinator i Komisionit Qytetar, në buxhet të planifikohet një fond për ujin e pijshëm që situatë e ujit të pijshëm mos të përsëritet më si sivjet.

Adelina Gjordeni: Qendra Artizane “Margarita” të planifikohet një fond në buxhet për qendrën tone për lëvizjet që bënë qendra nëpër panaire të ndryshme.

Piro Xheblati: Punjonjës i Shërbimit Social, të planifikohet një fond për t'i ardhur në ndihmë familjeve në nevojë 25 – 30 fëmije për dhënie e librave falas.


Banor i Uznovës: Lidhur me shkollën e Uznovës , çfarë do bëhet ? Më shqetëson ambjenti rrethues. Kërkohej edhe një kënd lojrash.

Llambi Guxhumani: Jam banor i lagjes Mangalem, ku sjelle falenderime në emer të lagjes për ndriçimin e rrugës “ Llambi Guxhumani”.

- Disa banesa në Lagjen “Mangalem” janë të pabanuara , drejt amortizimit dhe shembjes , pasi banorët janë në emigracion, duhet të ndërhyhet.
- Jam i mendimit që kur të vijnë fonde për lagjet muzeale t'i kalojnë ATELIES dhe jo firmave private.
- Ngreh shqetësimin që kur bëhen punime të ndryshme nuk kthehet ambjenti në gjendjen e mëparëshme.
- Kur u bënë punime në Lagjen “Mangalem” duhet që të gjitha kabllot të futeshin nëpër kanale. Mangalemi është shumë i vizitueshem nga turistët.
- Banorët e lagjeve muzeale e kanë të domosdoshme riparimet e banesave , t'u jepet një kredi nga banka pa interes me një afat 25 vjet siç ka qënë para vitete 1990.

MBAJTËSI I PROCES VERBALIT

Mevlude Vrusho



PROCES VERBAL

I mbajtur sot në datë 29.08.2017 në dëgjesën publike për buxhetin afatmesem 2018-2020 si dhe projekt buxhetin 2018 me biznesin e qytetit Berat.

Në dëgjesë marrin pjesë: N/Kryetari i Bashkisë Z.Çlirim Brisku, këshilltarë dhe përfaqësues të biznesit të qytetit Berat.

Clirim Brisku: Hap takimin duke sqaruar rëndësinë e takimit. Dëgjesa publike është detyrim ligjor.

Fortunato Boçi: Kam një biznes në Lagjen Uznove, hotel, taksa e vendosur nga Bashkia për ballkonet e hotelit nuk më duket e drejte .

-Taksa për fjetje të shikohet pasi është e lartë.

-Trajtohemi shumë keq si biznes.

-Të garantohet uji dhe energjia 24 orë.

_Të shikohet mundësia për ngritjen e një këndi lojrash tek Qendra "Lira".

-Ndriçim nuk ka.

Artan Spahu: Kam një biznes të vogël, ku më shqetëson çmimi i ujit , i cili është njësoj si atëherë kur kishte ujë 24 orë dhe tani që nuk kemi ujë.

- Papunësia e fëmijëve është shqetësuese, pasi mbarojnë shkollat dhe nuk kanë ku të punojnë.

- Ujërat e zeza "Rruga e Hebrenjve" dalin në rruga , duke të bëhen kanalizime.

- Bizneset duhet të trajtohen njësoj nga tatimorët , tavolinat e lokaleve kanë zënë bulevardin, trotuaret , nuk ke ku të kalosh. Biznese të tëra pa licensa.

- Bizneset tek pedonalja taten njësoj si bizneset e lagjeve.

Luan Xhafellari: Kam një biznes të vogël elektrik. Duhet të bëhet mdarja e bizneseve që çfarë ata tregëtojnë, p.sh fruta zarzavatet sheshin paisje elektrike, taksat paguhen njësoj si ai që tregëton në Bulevardin kryesor dhe ne që jemi nëpër lagje.

- Kërkojmë të bëhet një kënd lojrash në lagjen " 30 Vjetori" për fëmijët.

Kastriot Eski: Kam një biznes në qendër të qytetit, kërkoj që të ndryshohet orari i ujit.

-Tek Poliklinika në qendër ka kanazë plehrash, a mund të lëvizin që aty , ose të ngrihet një mur i vogël sepse gjithë papaspërtitë vijnë tek lokali im.

Mehmet Vrapi: Rruga Nacionale të lahet një herë në javë, pluhuri është prezentë kudo , ky është shqetësim edhe nga turistët.

Koçi..... : Rrugët e lagjeve muzeale të Beratit Kala,Mangalem,Goricë, duhet të jenë më të pastra. Duhet të vini kutira në largësi nga njera tjetra për plehrat.

- U gërrye rruga përpara Mangalemit vjet, tymi ngrihej dhe shkonte i gjithi në Lagjen Mangalem. Pse heshtet dhe e latë për një kohë të gjatë pa u asfaltuar?
- Njëkohësisht rruga që fillon tek Xhamia e Beqarëve , është gërryer dhe akoma nuk është asfaltuar.
- Shëtitorja pse nuk lahet?
- Kërkohet furnizimi me ujë të bollshëm.

MBAJTËSI I PROCES VERBALIT

Mevlude Vrusho

